

“MASTER I SHKENCAVE” NË “MËSUESI NË GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI”

Emërtimi akademik i studimit	DIPLOMË UNIVERSITARE “MASTER I SHKENCAVE” NË “MËSUESI NË GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI”						
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	Ne proces						
Cikli i studimit	Cikli i dytë i studimeve “Master i shkencave” në “Mësuesi në Gjuhë shqipe dhe Letërsi”						
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej”; Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore; Njësia bazë e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë; institucion publik; i akredituar						
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip						
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	2 (dy) vjet						
Forma e studimit	Me kohë të plotë						
Kushtet e pranimit	<p>1. Pranimi i studentëve në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses një program të ciklit të parë të studimeve “<i>Bachelor</i>”, i cili jep akses në programet e ciklit të dytë të studimeve, në fushën e mësuesisë.</p> <p>2. Kriter pranimi në këtë program të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave” është njohja nga kandidati e një prej 5 (pesë) gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: (<i>anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht</i>), në nivelin B₁, sipas akteve nënligjore të MAS-it. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.</p> <table border="1" data-bbox="521 1314 1446 1839"> <tr> <td data-bbox="521 1314 789 1528">Nga i njëjti Institucion i Arsimit të Lartë, Universiteti “Eqrem Çabej”</td> <td data-bbox="789 1314 1446 1528"> <p>a. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve, “<i>Bachelor</i>” në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.</p> <p>b. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve “<i>Bachelor</i>”, në programe studimi të përfafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë.</p> </td> </tr> <tr> <td data-bbox="521 1528 789 1703">Nga Institucione të Arsimit të Lartë, brenda vendit</td> <td data-bbox="789 1528 1446 1703">Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve “<i>Bachelor</i>”, brenda vendit, në institucione të arsimit të lartë të akredituara, në programe studimi të njëjta apo të përafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë.</td> </tr> <tr> <td data-bbox="521 1703 789 1839">Nga Institucione të Arsimit të Lartë, jashtë vendit</td> <td data-bbox="789 1703 1446 1839">Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve, “<i>Bachelor</i>”, në programe studimi të njëjta apo të përafërta jashtë vendit dhe kanë kryer njehsimin pranë MAS-it.</td> </tr> </table>	Nga i njëjti Institucion i Arsimit të Lartë, Universiteti “Eqrem Çabej”	<p>a. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve, “<i>Bachelor</i>” në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.</p> <p>b. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve “<i>Bachelor</i>”, në programe studimi të përfafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë.</p>	Nga Institucione të Arsimit të Lartë, brenda vendit	Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve “ <i>Bachelor</i> ”, brenda vendit, në institucione të arsimit të lartë të akredituara, në programe studimi të njëjta apo të përafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë.	Nga Institucione të Arsimit të Lartë, jashtë vendit	Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve, “ <i>Bachelor</i> ”, në programe studimi të njëjta apo të përafërta jashtë vendit dhe kanë kryer njehsimin pranë MAS-it.
Nga i njëjti Institucion i Arsimit të Lartë, Universiteti “Eqrem Çabej”	<p>a. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve, “<i>Bachelor</i>” në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.</p> <p>b. Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve “<i>Bachelor</i>”, në programe studimi të përfafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë.</p>						
Nga Institucione të Arsimit të Lartë, brenda vendit	Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve “ <i>Bachelor</i> ”, brenda vendit, në institucione të arsimit të lartë të akredituara, në programe studimi të njëjta apo të përafërta, të cilat japin akses në fushën e mësuesisë.						
Nga Institucione të Arsimit të Lartë, jashtë vendit	Kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve, “ <i>Bachelor</i> ”, në programe studimi të njëjta apo të përafërta jashtë vendit dhe kanë kryer njehsimin pranë MAS-it.						

- | | |
|--|--|
| | <p>3. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës mesatare të ciklit të parë “Bachelor”, deri në plotësimin e kuotave të shpallura. Në rast se numri i aplikimeve kalon kuotën e parashikuar të pranimeve nga Njësia bazë, atëherë kandidatët do të seleksionohen sipas:</p> <ol style="list-style-type: none"> Nivelit të përshtatshmërisë së diplomës “Bachelor” për vazhdimin e programit të ciklit të dytë të studimeve Master i shkencave në “Mësuesi në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi” Notës mesatare në programin e ciklit të parë të studimeve “Bachelor”. |
|--|--|

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit “Master i shkencave” në “Mësuesi në Gjuhë shqipe dhe Letërsi”: është të aftësojë studentët në përsosjen dhe thellimin e njohurive shkencore, në aftësimin e tyre praktik, në krijimin e individualitetit krijues, në rritjen e formimit të tyre profesional. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë, duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit:

1. Të zbatojnë njohuritë e fituara gjatë studimeve të Masterit e të analizojnë çështjet komplekse nga sfera e studimeve të gjuhës dhe kulturës.
2. Të njohin dhe përcaktojnë problemet dhe çështjet sipas rëndësisë së tyre.
3. Të grumbullojnë dhe të sintetizojnë të dhënat nga literatura profesionale.
4. Të njohin alternativat e tyre për problemet e veçanta, duke bërë një zgjidhje praktike midis tyre.
5. Të reflektojnë në mënyrë krijuese proceset e mësimin.
6. Të bëjnë analizat e përgjithshme dhe të veçanta në sferën e gjuhëve, kulturave dhe komunikimit.
7. Të përpunojnë nga aspekti shkencor dhe praktik, dallimet, nevojat e jetës dhe shkencës.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e mësuesit të Gjuhës shqipe dhe Letërsisë, punonjësit kërkimor-shkencor, redaktorit gjuhësor dhe letrar, specialistit të administratës shtetërore, punonjësit në media të shkruara dhe audio-vizive etj.

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi kërkimore-shkencore, që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjedisin publik dhe jopublik, në të cilin do të veprojë si i punësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla, si: Gramatikë e thelluar e gjuhës shqipe, Konceptet bazë të kurrikulës kombëtare në gjuhë shqipe dhe letërsi, Histori e zhvillimit të letërsisë shqipe dhe botërore, Metodatat e kërkimit në edukim, Didaktikë e gjuhës shqipe dhe letërsisë etj.

VEPRIMTARITË FORMUESE

- 1. Lëndëbazë:**Psikologji zhvillimi dhe edukimi(viti i parë).Konceptet bazë të kurrikulës kombëtare në gjuhë shqipe dhe letërsi (AMU-AML) (viti i dytë).**Kredite 12(dymbëdhjetë).**
- 2. Lëndë karakterizuese:** Metodologji e mësimdhënies dhe të nxënit, Histori e zhvillimit të letërsisë shqipe, Kurrikula dhe arsimi gjithëpërfshirës, Vlerësim i të nxënit, Semantikë, Gramatikë e thelluar e gjuhës shqipe, Histori e zhvillimit të letërsisë botërore(viti i parë). Analizë teksti, Didaktikë e gjuhës shqipe, Didaktikë e letërsisë, Gjuhësi teksti(viti i dytë).**Kredite 66(gjashtëdhjetë e gjashtë).**
- 3. Lëndë integrale:** Kulturë gjuhe,Metodat e kërkimit në edukim, Menaxhimi i klasës(viti i parë).Letërsi për fëmijë e të rinj(viti i dytë).**Kredite 16(gjashtëmbëdhjetë).**
- 4. Lëndë me zgjedhje:**Hyrje në indoevropianistikë, Onomastikë, Gjuhësi ballkanike, Interpretimi i veprave letrare (letërsi shqipe), Letërsi ballkanike, Edukimi për median dhe informacioni për mësuesit e ardhshëm(viti i dytë).**Kredite 8(tetë).**
- 5. Lëndë plotësuese:**Praktikë mësimore profesionale pasive dhe aktive. **Kredite 12 (dymbëdhjetë).**
- 6. Përgatitje punim diplome:****Kredite 12(dymbëdhjetë).**

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	Deri në 44 pikë
5 (pesë)	45-54 pikë
6 (gjashtë)	55-64 pikë
7 (shtatë)	65-74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj e ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Mësuesi në Gjuhë shqipe dhe Letërsi” është urë lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë ndërtuar mbi konceptet bazë të mësimdhënies e mësimnxënies, sipas kornizës kurrikulare kombëtare, është konceptuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate të përshtatshme të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë që ky program studimi ofron.

Studenti, i cili diplomohet në programin e studimit “Master i shkencave” në “Mësuesi në Gjuhë shqipe dhe Letërsi” mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit të tretë të studimeve, programet e studimeve specializuese afatgjata, studime të doktoraturës apo në një fushë të ngjashme. Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit, mbarimi i këtij cikli jep mundësinë për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë të studimeve, në programin:

1. Studime doktorale për të marrë gradën shkencore “Doktor”

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t’u hapen mundësitë për punësim më të sigurt dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë / ekspertë / mësues të specializuar në fushat e Gjuhësisë dhe Letërsisë, të kualifikuar me njohuri të tilla, si Gramatikë e thelluar e gjuhës shqipe, Konceptet bazë të kurrikulës kombëtare në gjuhë shqipe dhe letërsi, Histori e zhvillimit të letërsisë shqipe dhe botërore, Metodatat e kërkimit në edukim, Didaktikë e gjuhës shqipe dhe letërsisë etj.

Për këtë arsye synimi i programit të studimit “Master i shkencave” në “Mësuesi në Gjuhë shqipe dhe Letërsi” është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen:

1. Mësues i Gjuhës shqipe dhe Letërsisë
2. Punonjës kërkimor-shkencor
3. Redaktor gjuhësor dhe letrar
4. Specialist i administratës shtetërore
5. Punonjës në median të shkruara dhe audio-vizive etj.

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit “Master i shkencave” në “Mësuesi në Gjuhë shqipe dhe Letërsi”, fitojnë njohuri më të thelluara në: Gramatikë e gjuhës shqipe, Kurrikulën kombëtare në gjuhë shqipe dhe letërsi, Historinë e zhvillimit të letërsisë, Metodatat e kërkimit, Metodologjinë e mësimdhënies etj.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i parë				
1.	Psikologji zhvillimi dhe edukimi	6	150	I
2.	Metodologji e mësimdhënies dhe të nxënit	7	175	I
3.	Histori e zhvillimit të letërsisë shqipe	6	150	I
4.	Kurrikula dhe arsimi gjithëpërfshirës	5	125	II
5.	Vlerësim i të nxënit	6	150	II
6.	Semantikë	4	100	I
7	Gramatikë e thelluar e gjuhës shqipe	8	200	I + II
8	Histori e zhvillimit të letërsisë botërore	7	175	II
9.	Kulturë gjuhe	5	125	I
10.	Metodat e kërkimit në edukim	3	75	II
11.	Menaxhimi i klasës	3	75	II
Gjithësej viti i parë		60 ECTS	1500 orë	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Konceptet bazë të kurrikulës kombëtare në gjuhë shqipe dhe letërsi(AMU-AML)	6	150	I + II
2.	Analizë teksti	4	100	I
3.	Didaktikë e gjuhës shqipe	4	100	I
4.	Didaktikë e letërsisë	4	100	I
5.	Gjuhësi teksti	5	125	I
6.	Letërsi për fëmijë e të rinj	5	125	I
Lëndë me zgjedhje në gjuhësi dhe në letërsi				
7.	• Hyrje në indoevropianistikë	4	100	II
	• Onomastikë			
	• Gjuhësi ballkanike			
8.	• Interpretimi i veprave letrare (letërsi shqipe)	4	100	II
	• Letërsi ballkanike			
	• Edukimi për median dhe informacioni për mësuesit e ardhshëm			
9.	Praktikë mësimore profesionale pasive dhe aktive	12	300	I + II
10.	Punim diplome	12	300	
Gjithësej viti i dytë		60 ECTS	1500 orë	

